

AFRIM KRASNIQI**TREGIMI I (PA)PLOTË MBI PAVARËSINË:
RISHKRIMI I HISTORISË DHE SJELLJA SHTETËRORE
PAS VITEVE '90**

Në dhjetor '90 kur mori jetë sistemi i ri politik, shoqëria shqiptare trashëgonte memorie gjysmake dhe të deformuar ndaj Pavarësisë dhe etërve themelues. Rreth gjysma e firmëtarëve dhe kontribuuesve të Pavarësisë ishin konsideruar përgjatë katër dekadave si armiq dhe kundërshtarë të regjimit, emri dhe kontributi i tyre ishin retushuar dhe censuruar, miti i PPSH-së dhe komunizmit ishte shumë më i madh sesa piedestali i Pavarësisë. Gjatë një anketimi¹ të bërë disa vite më parë rreth kësaj periudhe, përqindja e atyre që besonin se E.Hoxha ka rol në Pavarësinë e vitit 1912 ishte shumë më i madh sesa konfirmimi për themeluesit e vërtetë, - një tregues i nivelit të lartë të dezinformimit, manipulimit dhe propagandës me të cilën më shumë se dy breza ishin formuar.

Për pasojë, procesi i ndryshimit të sistemit dhe ai i rehabilitimit, rishkrimit të të vërtetave historike dhe e krijimit të një historie kombëtare e shtetërore rezultoi të ishte shumë më i vështirë sesa ishte menduar. Motivet lidhen jo vetëm me nivelin e lartë të retushimit gjatë viteve 1946-1990, periudhë e censurës shtetërore mbi kriteret ideologjike, por edhe me mënyrën sesi mori jetë pluralizmi politik dhe sistemi i ri. Thirrja “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa!”, ajo për Himnin Kombëtar, për Fishtën, Konicën, Frashërin² etj., paralajmëronin një fillim të ri në rindërtimin e memories historike. Teza që lidhen me bashkimin kombëtar, modelin demokratik të shtetit, lirinë dhe kulturën, hapjen dhe identitetin, zunë vend në ligjërimin e ri, në përpjekje për të fituar kohën e humbur historike dhe për të mbushur zbrazëtinë, që rënia e regjimit po

¹ Sondazhi “Rinia e sotme: sa e njohin të kaluarën komuniste”, ISP & CEMI, Tiranë, 17.5.2015.

² Afrim Krasniqi, *Fundi i Siberisë Shqiptare*, Tiranë: Albin, 1998, f. 89.

linte pas. Etja ishte më e madhe sesa hapësira për ndryshim dhe mekanizmat në dispozicion.

Më 28 nëntor 1992, Shqipëria festoi 80-vjetorin e Pavarësisë, i pari jubile në një sistem jo ideologjik pas vitit 1937. Gjashtë jubiletë e tjerë, një nën pushtim dhe pesë në sistemin njëpartiak, komunist ishin dominuar nga elementët ideologjikë e propagandistikë, kryesisht në funksion të datës pasuese, përvjetorit zyrtar të çlirimit. Me një shkëputje 60-vjeçare nga tradita shtetërore dhe memoria historike, Shqipëria e vitit 1992 u ndesh në sprovë të mëdha e të shumëfishta për rehabilitimin e rishkrimin edhe të historisë së Pavarësisë. Ndryshimi i sistemeve politike më 1990 dhe rotacioni politik më 1992, sollën në krye të shtetit forcat demokratike, por ndryshimi kulturor dhe raportet me kujtesën historike ishin shumë më komplekse sesa zgjedhjet politike. As partitë dhe as institucionet e reja shtetërore e kushtetuese nuk kishin një vizion të qartë trajtimi mbi të kaluarën, përfshirë procesin e rivlerësimit të individëve dhe ngjarjeve, sidomos ato të Luftës II Botërore dhe periudhës së gjatë që pasoi nën diktaturë. Në kontrast me këtë udhëkryq, partitë dhe institucionet e reja kishin konsensus të gjerë në referimin e periudhës dhe aktit të Pavarësisë 1912, si pikënisje e shtetit, e simboleve dhe institucioneve të tij, por kishin ndarje të forta rreth rolit dhe nderimit të firmëtarëve.

Në nëntor 1992 u shënuan aktet e para publike të nderimit dhe të vlerësimit të ngjarjeve dhe personazheve, që lidhen me krijimin e shtetit dhe kontributet përgjatë dekadave. Ato shërbyen për të rikthyer vëmendjen dhe fokusuar memorien, edhe pse nuk pati analiza dhe vlerësime në thellësinë e problematikës që lidhen me individët dhe ngjarjet e periudhës së Pavarësisë. Burimet studimore dëshmojnë se vetëm në periudhën prill-dhjetor 1992 u akorduan 900 dekorime, ku shteti i ri me 650 dekorata vlerësoi në veçanti “*veprimtarët e Rilindjes Kombëtare, atdhetarët e luftës për pavarësi dhe mbrojtjen e tërësisë tokësore, krijimin dhe përhapjen e shkollës shqipe etj*”³. Drejtuesit e rinj të shtetit u kujdesën ta plotësojnë përvjetorin e parë në liri me hapjen drejt komuniteteve shqiptare në rajon dhe në diasporë, përfshirjen në procesin e ri pajtimit kombëtar të një numri sa më të madh individësh dhe në shndërrimin e festimeve të 28 Nëntorit si moment kulmor në kalendarin e datave dhe festave zyrtare. Bashkimi i datës së Pavarësisë

³ Filip Rrumbullaku, *Dekorimet: Nga Princ Wied deri sot*, Tiranë: Onufri, 2010, f. 342.

dhe datës së Çlirimit ishte proces dytësor në klimën e re, në të cilën, hidheshin themelet e një sistemi të ri reference ndaj historisë dhe ngjarjeve historike. Koha e shkurtër e përgatitjeve dhe zhvillimet e shpejta politike nuk lejuan realizimin në kohë të procesit të rehabilitimit të ngjarjeve e personazheve që lidhen me Pavarësinë, por krijuan kushtet dhe klimën për një synim të tillë⁴.

1991: Shqipëria një vit në kërkim të simboleve të reja

Hapat drejt procesit të rivlerësimit historik do të kërkonin ndryshim të sjelljes shtetërore, akte kushtetuese dhe ndërgjegjësim publik, cilësi të brishta në vitet '90-'91 në Shqipëri. Një muaj pas jetësimit të pluralizmit politik Presidiumi i Kuvendit Popullor nxori një dekret sipas të cilit *“përmendoret, bustet dhe memorialet e çdo lloji kushtuar figurave të ndritura të historisë dhe të kulturës së popullit tonë, Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu; patriotëve të mëdhenj të Rilindjes, si vëllezërit Frashëri; luftëtarëve të shquar të Pavarësisë, si Ismail Qemali; personaliteteve të shënuar të luftës për demokraci, si F. S. Noli; udhëheqësit të Luftës Nacionalçlirimtare dhe themeluesit të shtetit të ri shqiptar Enver Hoxha dhe veprimtarëve të tjerë të shquar në jetën shumëshekullore të popullit tonë, janë monumente të paprekshme dhe mbrohen me ligj nga shteti”*. Po ashtu me ligj do të mbroheshin edhe *“flamuri kombëtar, stema e simbole të tjera të Republikës”*⁵.

Cila mund të ishte lidhja midis Skënderbeut, Rilindjes Kombëtare, luftëtarëve për Pavarësi, Ismail Qemal Vlorës dhe Enver Hoxhës? Studiuesi Rago, thekson se, PPSH-ja e përdori Rilindjen Kombëtare për ta paraqitur Lëvizjen Komuniste si vijuese të saj, si lëvizje që mishëronte fitoren përfundimtare të Rilindjes⁶. Vetë Hoxha kishte shkruar se Rilindja Kombëtare ishte *“një lëvizje novatore pararendëse e revolucionit marksist dhe mjet për të dalë nga errësira mesjetare-feudale imperialiste, në dritë, në kryengritje, në luftën për liri, pavarësi, demokraci, për dritë*

⁴ Aleksandër Meksi, *Rrugë e vështirë. Shkrime dhe intervista*, Tiranë: Barleti, 2015, f. 201.

⁵ Dekret, Nr. 7459, datë 22.1.1991, *“Për respektimin dhe mbrojtjen e monumenteve që lidhen me historinë kombëtare dhe të simboleve shtetërore”*.

⁶ Paolo Rago, *Tradita, nacionalizmi, komunizmi në Shqipërinë bashkëkohore*, Tiranë: Dudaj, 2012, f. 238.

dhe arsim”⁷. Kriteri i barazimit midis Rilindjes, Pavarësisë dhe Lëvizjes Komuniste ishte ende funksional edhe në nisjen e vitit 1991. Natyrisht theksi i dekretit lidhej vetëm me emrin e vetë Hoxhës dhe vendosja në të njëjtën linjë e diktatorit me etërit e Pavarësisë dhe Heroin Kombëtar shprehte mentalitetin e kohës dhe konceptin e vazhdimësisë së sistemit të vjetër edhe në sistemin e ri. Mbrojtja me ligj e stemës dhe simboleve të Republikës, të cilat në janar 1991 ishin simboli i Kongresit të Përmetit, kallinjtë e grurit dhe ylli me pesë cepa, gjithashtu, jepnin mesazhin se ndonëse pluralizmi politik është lejuar, sistemi i ri do të ishte shtojcë e sistemit të vjetër, në koncepte dhe në mite ideologjike.

Më 25 prill 1991, rreth 5 muaj pas vendosjes së pluralizmit politik dhe rreth një muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve të para pluraliste parlamenti u mblodh për të debatuar mbi nevojën e vendit për një kushtetutë dhe simbole të reja shtetërore. Në fund të diskutimeve u vendos abrogimi i Kushtetutës së vitit 1976 e bashkë me të, edhe heqja e simboleve të sistemit komunist. Në debatin parlamentar të zhvilluar me këtë rast, një numër deputetësh kërkuan që simbolet e reja të shtetit të ndryshojnë pikën e referimit, nga simbolika e Kongresit të Përmetit, 1944 tek simbolika e Pavarësisë 1912. Argumenti kryesor lidhej me domethënien e datave dhe rëndësinë e tyre në memorien shtetërore e kombëtare. Për një prej deputetëve të rinj, B.Golemi, *“data 24 maj 1944 është data e krijimit të shtetit të diktaturës së proletariatit dhe jo data që shënon krijimin e shtetit të parë shqiptar. Këtu mendoj se nuk ka nevojë as për datën e krijimit të shtetit të Arbrit, por vendosja e datës, 28 Nëntor 1912, Dita e Pavarësisë së Shqipërisë, më duket e gjetur”*⁸. Më tej u propozua se *“do të ishte më mirë që të kishim si simbol të Republikës sonë vetëm një shqiptonjë të zezë dykrenore me mbishkrimin 28 Nëntor 1912”*.

Çështja e ndryshimit të simboleve dhe debati mbi referencën historike do të vijonte gjatë gjithë vitit 1991. Pika kulmore e debatit ndodhi në seancat parlamentare të fundit të nëntorit dhe fillimit të dhjetorit 1991, kur u zhvilluan festimet e para mbi Pavarësinë në sistemin e ri shumëpartiak. Tri nisma parlamentare, dy nga opozita (PD) dhe një nga mazhoranca (PS) kërkonin të konfirmonin Tiranën kryeqytet, *“të*

⁷ Enver Hoxha, *Raporte dhe Fjalime 1967-1968*, Tiranë: Naim Frashëri, 1970, f. 368.

⁸ Debati parlamentar, datë 25.04.1991, në *“Punime të Kuvendit”*, Legjislatura e 12, Viti 1991, nr. 1-2, Botim i Kuvendit të RSH, 2002, f. 103.

lirohet Flamuri kombëtar nga simboli i komunizmit, ylli mbi shqiponjën dhe të mbetet ashtu siç ka qenë përpara 1944”, si dhe “të anulohet stema e Republikës, sepse nuk paraqet realitetin historik të kombit dhe shtetit tonë”⁹. Parlamenti i vitit 1991 dështoi të ofrojë zgjidhje për këtë problematikë, ndërkohë që në seancat e para të punës parlamenti i ri i dalë nga zgjedhjet e marsit 1992 përfshiu në agjendën prioritare çështjen e simboleve¹⁰.

Gjatë periudhës prill 1991 - prill 1992, Shqipëria ishte zyrtarisht me simbolet shtetërore të vitit 1976. Nxitimi për të zgjidhur çështjen e simboleve ishte aq i madh, saqë në debatin e zhvilluar më 7 prill 1991 deputetët ngritën shqetësimin se anulimi i simboleve të vjetra komuniste pa pasur vendimmarrje për ato të reja, e la vendin pa simbole shtetërore. Problemi i dytë lidhej me legjitimitetin e aktit; pas dorëheqjes së Presidentit Alia vendi ishte pa president funksional dhe deri në zgjedhjen e presidentit të ri nuk kishte autoritet të qartë ligjor që të mund të dekretonte ligjet e reja¹¹, përfshirë ligjin për anulimin e simboleve të periudhës komuniste dhe vendosjen e simboleve të reja. Ligji i parë që miratoi parlamenti i ri ishte heqja e simboleve komuniste nga Flamuri dhe nga stema e Republikës. Akti u shoqërua me heqje të simboleve të njëjta nga uniformat ushtarake e policore, duke i lënë ato përreth një vit tranzicioni midis dy ligjeve, pa simbole zyrtare.

Si përfundim, deri në nëntor 1992, rreth dy vite pas vendosjes së pluralizmit politik Shqipëria, zyrtarisht, nuk kishte ende flamur dhe simbole zyrtare¹². Vonesa në zgjidhje e kësaj problematike ka vlerë për të kuptuar vështirësitë e sistemit të ri për t’u ndarë edhe formalisht nga sistemi i vjetër dhe vështirësitë shumëfishe për të krijuar një identitet

⁹ Debati parlamentar, datë 7.04.1992, në “Punime të Kuvendit”, Legjislatura e 13, Viti 1992, nr. 1 – 2, Botim i Kuvendit të RSH, 2002, f. 39.

¹⁰ Kuvendi ngriti një Komision të Posaçëm parlamentar të kryesuar nga Azem Hajdari dhe të përbërë nga deputetët Aleksandër Meksi, Skënder Shkupi, Ndue Gjika, Abdi Baleta, Xhevat Lloshi, Luan Hajdaraga, Paskal Milo dhe Mehmet Çeliku. Komisioni zhvilloi disa seanca pune dhe konsultimi me ekspertë të njohur, përfshirë studiues të Institutit të Historisë, për të arritur në konkluzionet konsensuale mbi simbolet. Mandati i Komisionit ishte dy javë, por për shkak të debateve dhe kompleksitetit të çështjes mandati vijoi deri në nëntor 1992.

¹¹ Debati parlamentar, datë 7.04.1992, në “Punime të Kuvendit”, Legjislatura e 13, Viti 1992, nr. 1 – 2, Botim i Kuvendit të RSH, 2002, f. 35.

¹² Debati parlamentar, datë 10.11.1992, në “Punime të Kuvendit”, Legjislatura e 13, Viti 1992, nr. 7, Botim i Kuvendit të RSH, 2002, f. 2076.

krejtësisht të ri për sistemin demokratik. Paradoksi gjendej jo vetëm në simbole, por edhe në kontrastin e thellë midis Kushtetutës antipluraliste dhe vetë pluralizmit. Deri në prill 1991, katër muaj pas pluralizmit, ende ishte në fuqi Kushtetuta e vitit 1976, e cila në nenin 3 vinte në kundërshti të plotë edhe me vetë pluralizmin, duke njohur PPSH-ën si forcë të vetme udhëheqëse në shtet dhe në shoqëri. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria zyrtarisht vijonte të ishte Republikë Popullore Socialiste¹³.

Problematika e simboleve të shtetit, përfshirë edhe stemën e RSH, Flamuri etj., u zgjidh shumë vonë, më 10 nëntor 1992, pra shtatë muaj pas krijimit të Komisionit. Deputetët e parlamentit ranë dakord të kenë pikë referimi Kuvendin e Vlorës 1912 dhe Shpalljen e Pavarësisë. Në debatin parlamentar të datës 10 nëntor 1992, Kuvendi thirri për sqarime historianë të njohur dhe ekspertë të Institutit të Historisë. Në komentet rreth simboleve të reja shtetërore historiani Kristo Frashëri theksoi se *“për mua ka rëndësi një fakt me rëndësi juridike dhe është ky: Kuvendi i Vlorës, 28 Nëntor 1912, ishte ai që e shpalli flamurin që kemi ne sot flamur kombëtar, ishte Kuvend Kombëtar në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse aty morën pjesë delegatë nga Mitrovica, Peja, Prishtina, nga Tetova e Dibra, nga Shkupi, nga Çamëria dhe për këtë arsye ky flamur u quajt flamur kombëtar dhe jo flamur i shtetit”*¹⁴.

Ligji i ri¹⁵ përcaktoi stemën e Republikës¹⁶, duke rikthyer simbolet e përdorura të periudhës së Pavarësisë, nëntor 1912. Ai gjithashtu përcaktoi Himnin Kombëtar, të njëjtë me Himnin e mëparshëm, por me një dallim, duke shtuar strofën e ndaluar të Himnit ku citohej fjala “Zot”. Më tej, ligji konfirmoi festën kombëtare dhe kryeqytetin. Mbi këtë bazë,

¹³ Afrim Krasniqi, “Takimi i vështirë me pluralizmin politik: Kontraste juridike dhe politike”, në revistën *Optime, Albanian University*, Tiranë: 2014, f. 45-55.

¹⁴ Debati parlamentar, datë 10.11.1992, në “Punime të Kuvendit”, Legjislatura e 13, Viti 1992, nr. 7, Botim i Kuvendit të RSH, 2002, f. 2096.

¹⁵ Ligj “Për Flamurin, Stemën, Himnin Kombëtar, Festën Kombëtare dhe Kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë”. Ligji 7637, 13.11.1992, *Fletorja zyrtare*, nr. 9, Tiranë: 28 janar 1993.

¹⁶ Ligji përcaktoi se “Flamuri shtetëror i Republikës së Shqipërisë paraqet një fushë të kuqe me një shqiponjë dykrenore të zezë me krahë të hapur, sipas tipit tradicional të këtij shekulli, të vendosur në mes. Neni 3 Stema e Republikës së Shqipërisë paraqet një shqiponjë dykrenore të zezë, të vendosur mbi një shqyt [mburojë] të tipit "variaz" me ngjyrë të kuqe. Mburoja të ketë sipër një vijë të drejtë në ngjyrë të zezë, që vjen duke u ngushtuar në pjesën e poshtme. Në mburojë ka të shkruar përsipër me ngjyrë të zezë fjalët: "Republika e Shqipërisë".

institucionet e tjera iu referuan vendimmarrjeve të Vlorës për të përcaktuar datat simbolike për to. Dita Kombëtare e Ushtrisë u ndryshua nga 10 korriku në periudhën komuniste në 4 dhjetor, ditën e vendimit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës për krijimin e forcës ushtarake. Dita Kombëtare e Policisë u ndryshua duke vendosur datën 13 janar, dita e vendimmarrjes për trupën e policisë nga qeveria e Vlorës. Dita Kombëtare e Drejtësisë u vendos data 10 maj, që është dita e dekretimit të Kanunit të Zhurisë më 1913. Edhe një numër aktesh të tjera në sektorë të ndryshëm të qeverisjes kanë pikënisjen zyrtare të tyre në vendimmarrjet e viteve 1912-1913.

Siç rezultoi nga analiza e mësipërme dhe nga zhvillimet politike kalimi nga simbolet e periudhës komuniste tek një simbolikë e re shtetërore me bazë periudhën e Pavarësisë nuk ishte proces i lehtë dhe zgjati më shumë se një legjislaturë parlamentare në fillimet e tranzicionit. Asnjë parti politike nuk ka pasur kontestime për referimin në periudhën e Pavarësisë, por diferencat gjendeshin në vlerësimin për simbolikat e periudhave të tjera historike dhe vlera e tyre në sistemin e ri politik.

Rehabilitimi i firmëtarëve, një proces gati shekullor

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 1985¹⁷ Kuvendit të Vlorës i jepet më pak hapësirë sesa sqarimit të termit “*klasa punëtore në RPSSH*” ose secilit prej kongreseve të PPSH-së. Tek i njëjti subjekt, nga firmëtarët e Pavarësisë përmenden vetëm disa prej emrave të angazhuar në qeveri, si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Pandeli Cale, Dom Nikollë Kaçorri, Mehmet Dërralla, Abdi Toptani si dhe drejtues i Pleqësisë, Vehbi Agolli-Dibra. Emrat e plotë të qeverisë përmenden në shpjegimin mbi qeverinë e Vlorës, kurse disa nga firmëtarët e Pavarësisë, si Mit’hat Frashëri etj., citohen si tradhtarë në shpjegimet mbi “Ballin” në Luftën e Dytë Botërore. Pasqyrimi i mangët lidhej me konceptin e vetë regjimit për Pavarësinë dhe firmëtarët e saj.

Disa autorë, midis të cilëve edhe Elez Biberaj, kanë theksuar “*dëmi më i madh që bëri komunizmi nuk ishte ai ekonomik, por më fort moral dhe kulturor. Komunizmi prishi tiparet kombëtare dhe zhdukuri dinjitetin e*

¹⁷ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1985, f. 587.

*shqiptarëve*¹⁸”. Ky përcaktim lidhet edhe me sjelljen ndaj historisë dhe memories së Pavarësisë. Gjatë periudhës së komunizmit në tekstet shkollore, në emisione televizive, në fjalime dhe shtypin zyrtar, në aktivitetet memoriale dhe studimet mbi periudhën e Pavarësisë, etërit themelues u përballën me censurën dhe ridënimin edhe shumë vite pas vdekjes së tyre. Disa prej tyre ishin drejtpërsëdrejti viktimë të regjimit komunist, të tjerë u shpallën indirekt për shkak të gjendjes së tyre shoqërore, raportit me PPSH-në dhe rrjeti familjar, si dhe të gjithë u vlerësuan jo për atë çfarë bënë më 1912, por për raportet politike me PKSH gjatë viteve 1941-1944.

Nga ata firmëtarë që nuk mbijetuan deri në Luftën e Dytë Botërore fati personal kishte qenë në disa raste tragjik. Ismail Qemal Vlora vdiq gati i dëbuar në Itali më 1919, Luigj Gurakuqi u vra në Itali më 1925, Dom Nikollë Kaçorri vdiq në emigracion në Austri më 1917, Xhelal Koprëncka u vra me atentat më 1919 etj. Nga firmëtarët e Pavarësisë, pjesa më e madhe e atyre që jetuan deri në vitin 1944, patën fat tragjik. Ata u mënjanuan, u denigruan, u arrestuan ose u ekzekutuan nga regjimi i ri komunist. Për më se katër dekada ata u zhdukën nga memoria historike dhe publike për të rifituar njohjen dhe vlerësimin në sistemin e ri politik. Shembull tipik është Qazim Kokoshi, firmëtar në Vlorë dhe një figurë me rëndësi në historinë e Shqipërisë nga 1912 deri në arrestimin dhe ekzekutimin e tij më 1947¹⁹. Vetëm pas viteve '90, Kokoshi është rehabilituar, ai është dekoruar nga dy presidentë dhe ka titullin “Nderi i Kombit”. Gjatë tranzicionit janë publikuar disa libra e studime mbi aktivitetin e tij, janë dhënë medalje lokale dhe vlerësime që lidhen me emra rugësh dhe institucionesh lokale. Të njëjtën kurbë ndoqi edhe firmëtari tjetër i Pavarësisë, Shefqet Daiu. Ai do të ishte deputet në të parin parlament shqiptar dhe për vite me radhë figurë e rëndësishme politike në Elbasan. Daiu u arrestua më 1945 dhe vdiq në burg një vit më vonë²⁰. Pas vitit '90 ai ka marrë dy dekorata të larta dhe disa vlerësime, përfshirë emërtimin e një rruge dhe qytetarinë e nderit në Elbasan.

Një nga drejtuesit e Pleqësisë në Vlorë dhe anëtar në qeverinë e parë të saj, Lef Nosi, do të kishte gjithashtu ulje e ngritje të jashtëzakonshme përgjatë një shekulli. Nga deputet, ministër dhe anëtar i Regjencës, Nosi

¹⁸ Elez Biberaj, *Shqipëria në tranzicion: rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010*, Tiranë: AHS, 2011, f. 121.

¹⁹ Bardhosh Gaçe, *Ata që shpallën Pavarësinë Kombëtare*, Tiranë: Toena, 2012, f. 113.

²⁰ *Po aty*, f. 53.

u arrestua dhe u ekzekutua më 1946²¹, për t'u rehabilituar pas viteve '90. Busti i Nosit ndodhet tashmë në një nga sheshet e Elbasanit dhe emri i tij vlerësohet lart sidomos për kontributin në ruajtjen e dokumentacionit të periudhës së Pavarësisë, ku spikat Akti i Shpalljes së Pavarësisë. Mit'hat Frashëri, gjithashtu firmëtar i Pavarësisë²², do ta paguante me çmim të lartë angazhimin e tij në krye të një partie nacionaliste gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke u konsideruar një prej armiqve kryesorë të regjimit komunist. Brezat studentorë dhe pjesa më e madhe publike e periudhës 1944-1990 nuk mori asnjëherë informacion për prezencën e tij në Vlorë dhe as përkatësinë e tij familjare, përkundrazi, emri i tij konsiderohej simbol për tradhti të lartë ndaj atdheut dhe popullit. Frashëri vdiq në emigracion në SHBA. Pas viteve '90 aktiviteti dhe trashëgimia e tij është rehabilituar, shteti i ka akorduar medalje e vlerësime të larta, emrin e tij mban çmimi kryesor në Bibliotekën Kombëtare .

Zihni Kanina, gjithashtu firmëtar në Vlorë dhe me përvojë të mëvonshme në diplomaci, për shkak të angazhimit politik nationalist u arrestua dhe vdiq në burg më 1957. Bedri Pejani, një nga përfaqësuesit e njohur të Kosovës në Aktin e Pavarësisë, pati të njëjtin fat tragjik, arrestim me burg deri në vdekjen e tij më 1946. Në burgjet e sistemit komunist vdiq edhe delegati tjetër i Pavarësisë, Sami Vrioni, ndërsa një listë tjetër firmëtarësh patën persekutim personal dhe familjar, siç janë Vokopola, Karaosmani, etj²³. Disa prej firmëtarëve dhe dy delegatë të Pavarësisë që emigruan jashtë vendit më 1944 (Dhimitër Berati, Mustafa Kruja, Mit'hat Frashëri, Rexhep Mitrovica, si dhe Dervish Biçaku e Eqerem Vlora) bënë pjesë në listën e kriminelëve të luftës të shpallur nga regjimi komunist. Të gjithë emrat e mësipërm pas viteve '90 u rehabilituan, morën vlerësime të larta shtetërore dhe qytetari nderi nga bashkitë që përfaqësuan përpara një shekulli në Kuvendin e Vlorës.

Siç rezulton nga të dhënat, me një shkëputje gati 50-vjeçare, vetëm 80 vjet nga Pavarësia firmëtarët e saj u rizbuluan për publikun dhe shoqërinë, për tekstet shkollore dhe medien, për konferencat dhe studimet, për dokumentarët dhe muzetë, për institucionet lokale dhe qendrore. Edhe ky proces rivlerësimi, në një numër rastesh u shoqërua me kontestime dhe kritika, duke mbajtur si shkallë vlerësimi jo

²¹ *Po aty*, f. 138.

²² *Po aty*, f. 74-75.

²³ *Po aty*.

kontributin në Pavarësinë dhe krijimin e Shtetit, por pozicionet e tyre politike ndaj PKSH gjatë periudhës së Luftës II Botërore.

Kurba e vlerësimit për periudhën e Pavarësisë

Për të kuptuar kurbën e vlerësimit të shtetit shqiptar ndaj firmëtarëve të Pavarësisë dhe delegatëve të Kuvendit në Vlorë mjaftojnë të analizohen aktet e shtetit më 1937 (25-vjetori i Pavarësisë), më 1962 (50-vjetori i Pavarësisë) dhe më 2012 (100-vjetori i Pavarësisë). Më 1932 pati aktivitete masive shtetërore e publike në nderim të Pavarësisë dhe figurave të saj. Aktivitetet u përqendruan kryesisht në Tiranë, kurse në qytetet e tjera u zhvilluan ceremoni nderimi për flamurin dhe figurat e secilit qytet pjesëmarrës në Kuvendin e Vlorës më 1912. Për shkak se ende një pjesë e këtyre figurave ishin gjallë dhe aktivë në jetën publike, ata u përfshinë direkt në ceremoni, në kontribute muzeore dhe në organizim konferencash, në intervista e shkrime në medie dhe në debate publike. Sipas programit qeveritar 1932²⁴ në 20-vjetorin e Pavarësisë parashihej ngritja e përmendores në varrin e I.Qemalit, do të zhvilloheshin disa aktivitete kulturore dhe sportive, si dhe të gjitha bashkitë kryesore do të duhej të zhvillonin pritje zyrtare. Në programin e 25-vjetorit të Pavarësisë (1937) parashihej se përveç ceremonive, paradave dhe fjalimeve zyrtare të kishte një numër të madh aktiviteteve sportive dhe kulturore, me synim, përfshirjen e pjesës më të madhe të rinisë në to.

Në 50-vjetorin e Pavarësisë kriter kryesor vlerësimi dhe festimi nuk ishin vlerat kombëtare dhe kontributet nominale të të gjithë firmëtarëve të Pavarësisë, por përdorimi i ngjarjes për nevoja ideologjike të kohës. Sipas udhëzimit të Byrosë Politike dhe kalendarit të aktiviteteve të miratuar nga Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH-së, thelbi i festimeve të 50- vjetorit i dedikohet përdorimit të ngjarjes në funksion të propagandës së kohës *“për të njohur traditat patriotike të popullit tonë për liri e pavarësi”*, *“për të mobilizuar masat punonjëse të qytetit e fshatit”* si dhe *“për forcimin e mëtejshëm të unitetit”*²⁵. Më 1962, pjesa

²⁴ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi: Këshilli Ministror (KM), dosja nr. 152, Program i 20 vjetorit, Tiranë, 1932.

²⁵ AQSH, Vendim i Këshillit të Ministrave, dosje nr. 684, viti 1962 *“Mbi kremtimin e 50 vjetorit të shpalljes së pamvarësisë dhe dekrete të Presidiumit të Kuvendit popullor, mbi dekorimin e patriotëve me rastin e jubileut”*.

më e madhe e etërve themelues nuk jetonin më dhe disa prej tyre jetonin në emigracion duke mos u lejuar të kthehen në vendin e tyre. Regjimi i kohës shpalli katër ditë festime ku pjesën dominante të tyre e zinin festimet për 29 Nëntorin. Pjesë e vendimmarrjes ishte edhe vendimi që Presidiumi dhe qeveria, në mënyrë simbolike, të zhvendosen në Vlorë, ku të *“kryejnë funksionet e tyre ... aty ku u shpall pavarësia kombëtare më 28 nëntor 1912”*²⁶. I njëjti mekanizëm festimi do të aplikohet edhe më 2012 me rastin e 100-vjetorit, tashmë në një sistem të ri politik.

Tipari dallues i 50-vjetorit, - përqendrimi i festimeve në Vlorë, një zonë e njohur militante e PPSH-së, u ndryshua për 100-vjetor, duke i dhënë më shumë vëmendje kryeqytetit të vendit, Tiranës. Më 1962, PPSH-ja shpalli Vlorën *“Qytet hero”*, titull që në një formë tjetër, tashmë *“Nderi i Kombit”* u përsërit për të njëjtin qytet edhe në festimet e 100-vjetorit më 2012. Regjimi komunist përdori 50-vjetorin për dekorimin me titullin e lartë *“Hero i Popullit”* për disa personalitete, përfshirë ish kryeministrin Ismail Qemali, por edhe figura të tjera pa rol politik në Aktin e Pavarësisë, siç janë Bajram Curri dhe Selam Musai²⁷. Pjesë e vendimmarrjes ishte edhe vendimi për Monumentin e Pavarësisë. Për 100-vjetor pjesë e nderimeve u bënë edhe Ahmet Zogu etj., pa rol thelbësor në ngjarjet e Pavarësisë, si dhe vendimi për ngritjen e një monumenti tjetër të Pavarësisë tashmë në kryeqytet, në Tiranë.

Deformimi i thelbit të 50-vjetorit të Pavarësisë dhe përdorimi propagandistik i tij shprehet edhe në përcaktimin e aktiviteteve solemne, të tilla si, vendimi për të përgatitur *“një ekspozitë për rrugën e lavdishme historike të popullit tonë”*, *“të botohen dokumente të Luftës Nacional-Çlirimtare dhe dokumentet e Konferencës së I dhe të II, ato të Kongresit Antifashist, të Këshillit të Përgjithshëm”*, *“të inaugurohen me ceremoni një sërë objektesh që do të ndërtohen gjatë vitit 1962”*, *“të organizohet në nëntor muaji i traditës patriotike revolucionare”*, *“të botohen fletëpalosje të ndryshme nga Bashkimet profesionale dhe grupimet e ndryshme”*²⁸. Ashtu si në këtë përvjetor, edhe në përvjetorët pasues deri më 1991, citimi i figurave pjesëmarrëse të Kuvendit të Vlorës apo publikimi i dokumenteve arkivore ishte nën censurë të rreptë duke

²⁶ AQSH, Vendim i Presidiumit të Kuvendit Popullor, datë 23 nëntor 1962.

²⁷ Po aty, Vendim i Këshillit të Ministrave, dosje nr. 684, viti 1962 *“Mbi kremtimin e 50 vjetorit të shpalljes së pamvarësisë dhe dekrete të Presidiumit të Kuvendit popullor, mbi dekorimin e patriotëve me rastin e jubileut”*.

²⁸ Po aty.

eliminuar të gjithë emrat, të cilët në periudha të ndryshme ishin konsideruar pjesë “të klasave të përmbysura” apo “armiqtë e popullit”. Pjesë e listës së censuruar ishte edhe Lef Nosi.

Gjatë festimeve të 80, 90 dhe 100-vjetorit të Pavarësisë, përkatësisht në vitet 1992, 2002 dhe 2012 shteti shqiptar u fokusua për nxjerrjen në dritë dhe vlerësimin e elementëve, ngjarjeve dhe personazheve të rëndësishme të lëna në harresë nga periudha e mëparshme. Pothuajse të gjithë firmëtarët dhe delegatët e Pavarësisë dhe figura të tjera të rëndësishme që direkt apo indirekt janë të lidhura me ngjarjet e viteve 1912-1913 në Shqipëri, janë rehabilituar në periudha të ndryshme pas viteve '90.

Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë të gjitha nivelet e qeverisjes u përfshinë në procesin e rivlerësimit historik dhe nderimit të ngjarjeve dhe të themeluesve të shtetit. Programe të posaçme nderimi ndoqi Presidenti i Republikës, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe ministritë e linjës, Banka Qendrore, institucionet ushtarake dhe policore, si dhe bashkitë e ndryshme, të cilat më 1912 patën delegatë nga zona e tyre në Kuvendin e Vlorës.

Në qershor 2012, Presidenti i Republikës dekretoi dhënien e titullit “Nderi i Kombit” për të gjithë firmëtarët e Pavarësisë me motivacionin: *“Për meritat e tyre historike si figura të shquara të kombit dhe rolin e tyre madhor në krijimin dhe shpalljen e shtetit të lirë e të pavarur shqiptar, si finalizim i luftës dhe përpjekjeve të pareshtura të popullit lirishtës shqiptar në rrjedhë të historisë”*²⁹. Në të njëjtën ditë, Presidenti veçoi figurën e Ismail Qemalit, duke i akorduar titullin më të lartë të shtetit shqiptar, “Urdhri i Flamurit”, si dhe bashkia Vlorë mori urdhrin “Nderi i Kombit”. Në korrik 2012 u zgjodh Presidenti i ri Nishani, i cili me rastin e 28 Nëntorit akordoi dekoratën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” për dy figura, Myfit Libohova dhe Mehmet Dërralla³⁰. Dy dekoratat janë në nivel më të lartë nderimi sesa titulli “Nderi i Kombit”, një vlerësim disproporcional që do të shfaqej disa herë gjatë tranzicionit në vlerësimin e figurave dhe ngjarjeve të veçanta. Akordimi i dekoratës

²⁹ Presidenti dekoron firmëtarët e Pavarësisë. Referim edhe në gazetën Panorama, <http://www.panorama.com.al/100-vjetori-i-pavaresise-topi-dekoron-me-%E2%80%9Curdhri-e-flamurit%E2%80%9D-ismail-qemalin/>

³⁰ Dekoratat e akorduara nga Presidenti Topi dhe Nishani në vitin 2012 gjenden në arkivin presidencial në faqen zyrtare të institucionit <http://president.al/?cat=16&dekorata=true&s=2012&paged=3>.

së lartë të Flamurit Kombëtar, për Mbretin Zog, me cilësimin “Naltmadhnia e Tij, Zogu I, Mbret i Shqiptarëve (pas vdekjes)”. Motivacioni i Presidentit i njeh atij meritën “se hodhi themelet e ndërtimit dhe funksionimit të shtetit modern shqiptar, me orientim të qartë perëndimor evropian. Ideator dhe realizues i administratës së parë të shtetit shqiptar, si dhe i një legjislacioni bashkëkohor të niveleve të larta, që do t’i hapte rrugë emancipimit shoqëror dhe zhvillimit të vendit”³¹. Vlerësimi i Ahmet Zogut në 100-vjetorin e Pavarësisë dhe rikthimi ceremonial i eshtrave të tij për varrimin zyrtar në Tiranë u komentua gjerësisht si akt që dominoi festimet dhe mbivendosi nderimet zyrtare të shtetit për etërit themelues³².

Në vijim të akteve rehabilituese dhe rivlerësuese në nëntor 2012, Kuvendi i Shqipërisë në një ceremoni zyrtare nderoi të gjithë firmëtarët e Pavarësisë. Vlera më e veçantë e këtij akti protokollar ishte deklarata në emër të shtetit shqiptar e kryetarit të Kuvendit “*kërkoj ndjesë në emër të shtetit shqiptar për të gjithë vrasjet, persekucionin, arratisjet e detyruara gjatë regjimit komunist, për firmëtarët e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ndërtuesit e shtetit shqiptar*”³³. Deklarata të tilla kanë vlerë në memorien historike kur kthehen në sjellje institucionale dhe shoqërohen me akte konkrete. Parlamenti u investua në disa aktivitete për të jetësuar rehabilitimin e figurave të njohura themeluese të shtetit, të cilët janë injoruar, denigruar ose retushuar gjatë periudhës 1944-1990. 100-vjetori u shoqërua edhe me aktin tradicional të amnistisë, i cili është aplikuar rregullisht edhe më 1992 në 80-vjetorin e Pavarësisë, më 1997 në 85-vjetorin e Pavarësisë, më 2002 në 90-vjetorin e Pavarësisë, më 2007 në 95-vjetorin e Pavarësisë.

Aktet nderuese vijuan edhe në nivelet e qeverisjes lokale. Më 24 nëntor 2012, Këshilli i Bashkisë Korçë me unanimitet vendosi dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për pesë firmëtarët e Deklaratës së Pavarësisë nga ky qytet³⁴: Pandeli Cale, Thanas Floqi, Dhimitër Zografi, Dhimitër

³¹ Institucioni i Presidentit të Republikës, arkivi i dekorimeve, <http://president.al/?p=3278>.

³² Përveç debateve në medie dekorimi zuri vend kryesor në debatin parlamentar të zhvilluar në dy seanca parlamentare në muajin nëntor 2012. Diskutimet e plota janë publikuar në botimin “Punime të Kuvendit” Legjislatura e 7-të, 2012, nr. 5.

³³ Deklarata e kryetares së Parlamentit J. Topalli, 19 tetor 2012, arkivi i parlamentit (www.parlament.al)

³⁴ Vendim i Këshillit bashkiak Korçë nr. 95, datë 24.11.2012.

Mborja, Emanoil dhe Dhimitër Berati. Firmëtari i gjashtë Spiridon Ilo ishte nderuar me këtë titull disa vite më parë. Dy ditë më pas në Elbasan bashkia shpalli “Qytetar Nderi” firmëtarët e Pavarësisë nga ky qytet dhe ata që shpallën Pavarësinë në Elbasan, më 25 nëntor 1912, si dhe personalitete të tjera që lidhen me periudhën e Pavarësisë, si Mit’hat Frashëri, Lef Nosi etj³⁵. Vlerësime të njëjta u bënë edhe në Tiranë, Lushnjë, Peqin, Shijak, Kavajë, Gjirokastrë, Përmet, Durrës, Berat etj.

Pjesë e vlerësimeve për 100-vjetorin e Pavarësisë ishin edhe rikthimi në atdhe të eshtrave të disa prej figurave më të njohura të asaj periudhe dhe me kontribute të çmuara historike, siç ishin ato të Ahmet Zogut apo të zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Imzot Nikoll Kaçorri. Gjithashtu u ndërmorën akte të tjera përkujtimore dhe vlerësuese, përfshirë vendosje të busteve të disa ish firmëtarëve të Pavarësisë në sheshe apo emërtime rrugësh e shkollash me emrat e tyre. Më 2013 qeveria avancoi më tej fokusimin tek viti 2012, duke urdhëruar ndryshimin e Protokollit të Ceremonialit zyrtar dhe zëvendësimin e portretit të Presidentit të Republikës me portretin e ish Kryeministrit Ismail Qemalit në të gjitha zyrat dhe mjediset shtetërore³⁶.

Problematika të nderimit dhe rivlerësimit

Ligjërimi politik post ’90 ka qenë i dominuar nga vlerësimet e larta për themeluesit e shtetit dhe periudhën e Pavarësisë. Gjatë viteve të tranzicionit secila qeveri dhe legjislaturë parlamentare ka deklaruar inspirim në aspiratat dhe interesat e larta kombëtare të etërve themelues. Krahas përdorimit simbolik e frymëzues të tyre, në ligjërimit politik personazhet e themelimit dhe periudha e Pavarësisë janë përdorur edhe si mjet i luftës politike, për t’i përdorur kundër palës tjetër dhe për të etiketuar rivalët politike për ecje në drejtimin e gabuar historik. Për shembull, në memorien parlamentare të vitit 2012, viti i 100-vjetorit të Pavarësisë, shumë më tepër ka citime të firmëtarëve dhe jubileut në kontestin e sulmit politik ndaj palës tjetër politike në parlament sesa në kontekstin festiv dhe atë historik. Një pjesë e madhe e pinjollëve të firmëtarëve të Pavarësisë u ftuan të nënshkruajnë peticione politike pro

³⁵ Vendim i Këshillit Bashkiak më datë 26.10.2012. <http://elbasani.gov.al/sq-al/Qyteti/Pages/qytetarnderi.aspx>

³⁶ Vendime të Këshillit të Ministrave, <https://kryeministria.al/newsroom/tre-vendimet-embledhjes-se-pare-te-keshillit-te-ministrave/>

një pale dhe kundër një pale tjetër politike në parlament, në funksion të agjendës politike ditore³⁷. Gjithashtu palët politike përdorën simbolet shtetërore të Pavarësisë në funksion të agjendës së tyre politike. Qeveria më 2012 nxiti një fushatë sensibilizimi patriotik duke i njohur vetes të drejtën historike për ta përfaqësuar këtë cilësi, kurse opozita ftoi qytetarët të bashkohen me nismën “një flamur për ballkon” në funksion të të njëjtit interes.

Shembulli më tipik i kontrasteve rreth përpjekjeve paralele për rivlerësim pozitiv dhe përdorim politik është debati i krijuar gjatë tranzicionit mbi datën e Çlirimit dhe rivaliteti midis festimeve të 28 dhe 29 Nëntorit. Në fundin e vitit 1992, parlamenti shqyrtoi dhe miratoi Ligjin mbi Festat Zyrtare³⁸, përmes të cilit, hoqi nga kalendari i festave pjesën më të madhe të festave të periudhës komuniste, përfshirë edhe datën 29 Nëntor, si dhe shpalli si festat fetare, të ndaluara prej dekadash në Shqipëri. Nëse për simbolet, stemën dhe himnin kishte konsensus politik të shumicës dhe pakicës parlamentare, për festat zyrtare vendimmarrja nxiti një pistë të re të konfliktit politik, e cila vijon edhe në ditët e sotme. Nëse teza e parë ishte se pati konsensus për korrektimin e gabimeve shtetërore e politike ndaj historisë, në rastin e 28-29 Nëntorit shohim se kemi të bëjmë me keqpërdorim të festave e simboleve shtetërore, përfshirë edhe Ditën e Pavarësisë, për interesa politike dhe elektorale.

Konkretisht, me një ndërhyrje të re ligjore në nëntor 1993, parlamenti përcaktoi se “28 Nëntori dita e Flamurit dhe e Çlirimit nga pushtuesit nazifashistë”. Më 1997, pas rotacionit politik mazhoranca e re bëri ndryshime në ligj³⁹ duke përcaktuar se “28 Nëntori dita e Flamurit dhe e Pavarësisë është ditë e festës kombëtare” dhe se “29 Nëntori, dita e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë”. Pas rotacionit të dytë politik, më 2005, mazhoranca e djathtë korrektoi qëndrimin e vitit 1992

³⁷ Letra u botua në mediet kryesore. Referim, Gazeta Shqiptarja.com, <https://shqiptarja.com/lajm/pasardhesit-e-firmetareve-te-br-pavaresise-apel-rames-voto-3-ligjet>

³⁸ Ligji nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare”, *Fletorja zyrtare*, nr. 10, Tiranë, 30.01.1993

³⁹ Ligj “Për një ndryshim në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 "Për festat zyrtare" ndryshuar me ligjet nr.7770, datë 7.12.1993, nr.7780, datë 22.12.1993 dhe nr.8065, datë 8.2.1996, Nr.8253, datë 30.10.1997.

dhe 1997⁴⁰ duke ofruar një formulë të mesme, ruajtur datën 28 dhe duke shpallur ditë pushimi edhe datën 29 Nëntor. E majta pas 2013-ës vijon të ndjekë praktikën e mëparshme.

Prej fillimit të viteve '90 çështjet protokollare të shtetit rregulloheshin me Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM). Sipas VKM "*Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë*" në listën e ditëve të rëndësishme të nderimit përfshihej edhe Dita e Pavarësisë. Ceremoniali ka ndryshuar disa herë, kryesisht për shkak të raporteve me 28 dhe 29 Nëntorin, si dhe me rolin e kryetarit të shtetit dhe kryeministrit, qeverisë qendrore dhe bashkisë në këto festime. Në tërësi VKM-ja ka mbetur unike në elementët protokollarë: një vend të veçantë në Ceremonialin e Shtetit zë "ceremonia e ngritjes së Flamurit Kombëtar". Ajo do të zhvillohej çdo 5 vjet në qytetin e Vlorës dhe do të paraprihej nga një Komision i Posaçëm Qeveritar, me pjesëmarrje të gjerë dhe një agjendë të ngjeshur me aktivitete. Në dallim nga disa prej ditëve dhe ngjarjeve të tjera protokollare, Ceremonia e Flamurit në Vlorë është e përcaktuar me ligj në detaje, përfshirë orën e nisjes dhe mbarimit, vendosjen e të ftuarve, rolin e secilit prej autoriteteve qendrore e lokale, mënyra e ecjes dhe e qëndrimit, nderimi për himnin, 21 të shtënat e topit, kurora tek varri i Ismail Qemal Vlorës, fjalimi i Presidentit, përshëndetjet, vizitat në familjet e patriotëve dhe të dëshmorëve, si dhe dreka zyrtare ku kryetari i bashkisë duhet të ngrejë një dolli dhe të bëjë përshëndetje. Pjesë e ceremonialit është pritja zyrtare e Presidentit në të njëjtën datë në mbrëmje në Pallatin e Brigadave etj.

Në variantin e VKM-së të vitit 2004 apo pas 2013-ës kur e majta është në pushtet, me vitet '90 apo pas 2005-ës, kur e djathta ishte në pushtet, dallim bën vetëm ndarja ose bashkimi i ceremonive të Flamurit me atë të Çlirimit. Kur e majta është në pushtet e djathta vendos kurora në Varrezën e Dëshmorëve me datë 28 Nëntor dhe anasjelltas, kur e djathta është në pushtet e majta vendos kurora në Varrezat e Dëshmorëve më datë 29 Nëntor. Madje, edhe kur një parti e djathtë dhe një e majtë bën koalicion (PD-LSI 2009-2013) identiteti ideologjik i tyre vijon të reflektojë ndarjen, njëra festonte përsëri 28 Nëntorin, tjetra vijonte me 29 Nëntorin. Të njëjtat praktika të ndara u aplikuan edhe në përvjetorët e

⁴⁰ VKM "Për disa ndryshime në vendimin nr. 229, datë 23.04.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë", Numri i Aktit: 735, Numri i *Fletores Zyrtare*: 89, 25.11.2005.

Çlirimit, e majta duke u dhënë rëndësi prioritare dhe e djathta duke lidhur nnderimet e Çlirimit me pasojat e regjimit që erdhi pas tij.

Gara për datën nuk ishin thjesht çështje paralelizmi, por edhe garë protagonizmi historik, trashëgimie dhe sjelljeve elektorale. Rivaliteti shpesh çoi në dominimin e një date dhe për pasojë, injorimin e tjetrës. Gjatë periudhës së qeverisjes së djathtë shumica e aktiviteteve zyrtare dhe kulmet festive datonin më 28 Nëntor dhe ajo konsiderohej dita më e rëndësishme e vitit politik. Gjatë qeverisjeve të majta 28 Nëntori kaloi në rend të dytë, duke ia kaluar prioritetin, vëmendjen dhe investimin shtetëror datës 29 Nëntor. Fokusi i ndarë i rëndësisë së datave, pavarësisht se kemi të bëjmë me Pavarësinë dhe Ditën e Flamurit, u reflektua edhe në nivele lokale, ku gjatë qeverisjes së djathtë aktivitetet kryesore artistike datonin më 28, kurse gjatë të majtës vijojnë të datojnë më 29 Nëntor. Madje edhe modeli i festimeve të njohura si “Nata e Bardhë”⁴¹, iniciuar nga Kryeministri Rama gjatë kohës që ishte kryetar bashkie në Tiranë (2000-2011), u ndërpre në mandatin e Bashës në krye të bashkisë (2011-2015) dhe është rikthyer sot gjatë mandatit të Veliajt në bashki (2015-2019). Më 2017, në 105-vjetorin e Pavarësisë, për shkak të raporteve të reja politike nga 2012, aktivitetet e “Natës së Bardhë” dominuan të gjithë agjendën festive, duke kaluar dytësore agjendën tradicionale të ditës së Flamurit dhe të Pavarësisë.

Aspekt i rëndësishëm i raportit të shtetit me memorien historike është ai i rishkrimit të historisë. Procesi vijon të ndodhë, ndërkohë që nuk ka më dilemë se regjimi i kaluar i manipuloi faktet dhe se breza të tërë qytetarësh janë rritur dhe edukuar me informacione të deformuara për një pjesë të madhe të etërve themelues. Në tekstet mësimore të çdo niveli, pas viteve '90, ngjarjet e Pavarësisë, firmëtarët dhe aktiviteti i tyre, janë pjesë organike, pa censurë dhe pa vlerësim mbi bazat e aktivitetit të tyre në pjesën fundore të jetës. Kjo sjellje shtetërore megjithëse pozitive dhe reflektuese ndaj gabimeve të së kaluarës, përsëri u dominua më shumë nga nevoja për agjendë politike dhe koncepti i “aksionit” sesa nga agjenda institucionale, e përpunuar dhe afatgjatë. Rehabilitimi dhe rishkrimi i historisë edhe në tranzicion u ndeshën në debate të zjarra

⁴¹ Sipas konceptit të “Natës së Bardhë” shteti organizon disa dhjetëra aktivitete kulturore e sportive me fokus kryesor mbrëmjen e datës 29 Nëntor. Pjesë e axhendës është edhe Peza, simboli i Konferencës së vitit 1942, si dhe simbolet e LANÇ dhe shpesh edhe të periudhës komuniste. Projekti datoi me mandatin e kryetarit të bashkisë, Rama në Tiranë dhe u ruajt edhe gjatës kohës kur ai ishte/është kryeministër.

publike, për shkak se palë të ndryshme, të motivuara politikisht, kërkonin në bigrafinë e themeluesve të shtetit momente pozitive ose negative, për të dhënë më pas vlerësime konfirmuese ose përjashtuese.

Analiza e ecurisë së këtij procesi, shoqëruar me elementë të tjerë, siç janë, muzetë e rinj, përmendoret, ceremonitë, nderimi simbolik në rrugë apo shkolla, në vende publike apo realizimi i dokumentarëve, mbështetja financiare për botimin e veprave të tyre të censuruara etj., tregojnë se sensi pozitiv dhe refraktar është shoqëruar edhe me spontanitet dhe nisma të pjesshme. Disa prej figurave të njohura të Pavarësisë ende nuk i kanë varret në Shqipëri, ndërtesa simbol dhe aktet e Pavarësisë ende janë të paplota, vlerësimi e nderimi ka qenë disproporcional i bazuar në lobimin politik, krahinor dhe familjar të pasuesve të tyre, dhe elementë të tjerë kritikë, të cilët në tërësi na bindin për të vlerësuar se ritakimi me Pavarësinë ende mbetet i papërfunduar.

Aspekt tjetër i analizës është akti zyrtar i nderimit shtetëror. Shqipëria miratoi më 1991 amnistinë e përgjithshme për viktimat e sistemit komunist dhe përmes saj, pranoi përgjegjësinë zyrtare ndaj kësaj shtrese, pjesë e të cilës ishin edhe disa prej familjeve të firmëtarëve të Pavarësisë, përfshirë edhe të vetë ish kryeministrit Ismail Qemal Vlorës. Më 2012 vlerësimet kulmuan me dekorime të larta presidenciale dhe nderime nga institucionet qendrore dhe bashkitë. Në historinë e shtetit shqiptar kjo ishte hera e parë që shteti nderon të gjithë firmëtarët së bashku. Procesi i nderimit nga kreu i shtetit zyrtarisht mbyll procesin e rehabilitimit dhe e vendos Pavarësinë në krye të hierarkisë së ngjarjeve historike. Vlerësime të tilla janë standarde për shtetet moderne dhe memorien kolektive. Në Shqipëri ato u shoqëruan me debate dhe kritika të arsyeshme. Për shembull, disa prej firmëtarëve të Pavarësisë, në momentin e nderimit presidencial, zyrtarisht mbanin dekorata e tituj më të lartë nderues sesa ai që morën në 100- vjetor⁴². Në hierarkinë e nderimeve shtetërore mbi 90% e tyre kanë dekorata e tituj më të ulët sesa figura të tjera me më pak kontribut historik, të nderuara gjatë 100-vjetorit të Pavarësisë, por pa lidhje direkt apo indirekte me të. Mungesa e një

⁴² Për shembull, Lef Nosi, Mit'hat Frashëri, Iljaz Vrioni etj., ishin nderuar më parë me Urdhrin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", dekorata e dytë më e lartë dhe më 2012 bashkë me firmëtarët morën dekoratën "Nderi i Kombit" dekorata e tretë më e lartë në RSH. Ismail Qemali në të njëjtën ceremoni më 2012 merr Urdhrin e Flamurit dhe kolektivisht edhe "Nderi i Kombit", përkatësisht dekoratën e parë dhe të tretë në hierarkinë e RSH.

sistemi referimi mbi vlerat dhe vlerësimet ka bërë që figura të shquara si p.sh. Luigj Gurakuqi, të kenë dekoratë e tituj më të ulët në hierarkinë e vlerësimeve sesa disa nga kryeministrat e politikanët e tranzicionit post '90⁴³. Madje, edhe dekoratën që mban simboli i Pavarësisë, Ismail Qemal Vlora, e kanë sot gjithashtu edhe shumë figura dytësore të asaj periudhe apo të periudhave të mëparshme, përfshirë edhe dy nga Presidentët e vendit prej të cilit u ndamë më 1912 për t'u bërë të pavarur.

I njëjti vlerësim jo proporcional meritash dhe nderimesh shprehet edhe në aktet e nxjerra nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet publike në Shqipëri që kanë një zë në këtë proces, siç janë universitetet, shkollat, institucionet e mbrojtjes, të sigurisë, të politikës së jashtme etj. Në Shqipërinë e sotme të pas 27 viteve tranzicion vetëm 10 nga 61 bashkitë e Republikës i kanë nderuar të gjithë delegatët e saj të Nëntorit 1912 në Vlorë dhe personalitetet e tjera të periudhës së shtetformimit. Megjithatë në inventarin aktual (2018) të bashkisë Tiranë në Vaqar ende ka një rrugë me emrin e Haxhi Qamilit⁴⁴, figurës antikombëtare të vitit 1914. Emri i tij vijoi të ishte deri më 2006 në shkollën e Sharrës në Tiranë. Raste të tilla, ku figura me kredenciale negative vijnë të jenë të nderuar, ndërkohë që shumë prej figurave të Pavarësisë dhe periudhës së shtetformimit nuk janë pjesë e emërtimeve, janë tregues i spontanitetit dhe formalitetit në procesin e rivlerësimit historik.

I njëjti trend shfaqet edhe në procesin e botimeve, kryesisht të librave biografik apo dokumentar dedikuar disa figurave historike, ku dominuese nuk janë kërkimet shkencore nga profesionistë të fushës, por botime të krijuara e sponsorizuara nga pinjollë të familjes. Midis tyre gjenden vlera, sidomos kur botohen dokumente të reja apo publikohen arkiva të panjohura familjare. Por në tërësi, një pjesë e madhe e këtyre botimeve më shumë se rivlerësim historik synojnë të krijojnë figura mitike, të cilat më pas, në kushtet e medias së shumëllojshme, lobimit dhe influencave politike e publike, i imponohen publikut si hierarki vlerash.

⁴³ Kryetari aktual i Kontrollit të Lartë të Shtetit B. Leskaj ka dekoratë më të lartë sesa Gurakuqi, ndërkohë që ish Kryeministri Berisha mban dekoratën më të lartë të shtetit shqiptar, "Urdhri i Flamurit" marrë më 8.12.2015, ish Kryeministri F.Nano mban dekoratën e dytë më të lartë, Urdhrin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" etj., secila dekoratë më e lartë sesa dekorata "Nderi i Kombit" që ka Gurakuqi etj.

⁴⁴ Më 2017 një komision i ngritur nga bashkia Tiranë po bën verifikimet dhe ndryshimet në emërtime. Komisioni ka rënë dakord për heqjen e emrit të tij, por vendimi nuk është ende ligjor për sa kohë nuk ka kaluar me votim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Nderimi i pjesshëm shtetëror për trashëgiminë e Pavarësisë

Merita më e madhe gjatë këtyre viteve në rishkrimin e historisë u përket studiuesve, historianëve dhe të gjithë atyre që kanë kaluar muaj e vite nëpër arkiva për të zbuluar fakte e të dhëna që e bëjnë memorien ndaj Pavarësisë më të plotë, më cilësore, më profesionale dhe më shteruese. Meritë e tyre janë botimet studimore gjatë këtyre viteve mbi volume me dokumente të plota e të pacensuruara nga arkivat austro-hungareze, britanike, italiane, franceze, amerikane, ruse, turke, greke etj., ashtu edhe nxjerrja nga pluhurat e harresës dhe censurës së dokumenteve me vlerë historike nga arkivat shqiptare.

Meritë e tyre është gjithashtu provokimi pozitiv i debateve mbi përmbajtjen dhe rëndësinë e dokumenteve historike, duke i lidhur ato me meritat dhe rolin e shumë prej individëve të cilët më pas gjatë jetimit të shtetit kanë pasur karrierë shpesh të ndryshme politike, si dhe ato mbi rolin e faktorëve ndërkombëtarë, rolin e elitave civile e fetare si dhe rolin e komuniteteve lokale. Edhe debati mbi numrin e themeluesve, nëse duhet kufizuar vetëm në 40 emrat e nënshkruesve në Deklaratën e Pavarësisë dhe nëse duhen përfshirë edhe emrat e tjerë që erdhën më vonë dhe ata që iu bashkuan punimeve të Kuvendit, - mbetet në çdo rast profesional dhe lidhet me këndvështrime të ndryshme të metodikës studimore. Por, nëse debati mbi ngjarjet dhe faktorët e tjerë ka qenë shumë profesional, ndihmues, qartësues dhe frymëzues, - debati për figurat historike kryesore ka mbetur peng i paragjyqimit bazuar në modelin politik të 28-29 Nëntorit.

Nisma të tjera të veçanta me vlerë, siç janë botimi i krijimtarisë së shumë prej figurave politike të viteve '12 dhe '20, hapja e muzeve lokale, botime të posaçme studimore, konferenca dhe kërkime shkencore, në tërësi kanë qenë e janë pozitive, megjithëse në kushtet e një buxheti minimal financiar shtetëror gjatë 27 viteve. Ato janë nxitur më shumë nga nevoja protokollare dhe pasioni i studiuesve sesa nga ndonjë projekt konkret shtetëror apo agjendë afatgjatë. Hapësira e shkëmbimeve me Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut ka lexuar zgjerimin e numrit të kërkuesve shkencorë dhe të interesit publik ndaj Pavarësisë dhe etërve themelues, si dhe ka lejuar pasurimin e arkivave dhe të debateve profesionale mbi individët dhe ngjarjet historike.

Ky bilanc vlerësues dhe as problemet ekonomike në të cilat ka kaluar Shqipëria gjatë tranzicionit nuk justifikojnë faktin se Shqipëria ende nuk ka një Muze dinjitoz për Pavarësinë, siç nuk ka një sistem të qëndrueshëm e të gjithëpranuar vlerësimi, nderimi dhe kultivimi të memories historike. Ndërtesa muzeore në Vlorë është simbolike, larg standardit të muzeve kombëtare, e rrethuar nga bizneset e periudhës së tranzicionit dhe e vështirë për të përçuar në pamje dhe përmbajtje qoftë simbolikën ashtu edhe rëndësinë e aktit dhe momentit historik që përfaqëson.

Përfundime

Takimi me pluralizmin dhe shoqërinë e lirë për shumicën shqiptare erdhi edhe si ritakim me Pavarësinë. Vetëm pas 1992 brezat e rinj dhe shumica qytetare patën rastin të mësojnë emrat e saktë të etërve themelues, nënshkrues të dokumentit të Pavarësisë së Shtetit të 28 Nëntorit 1912. Publikimi i fakteve dhe dokumentacionit të plotë rreth Pavarësisë ndikoi në krijimin e një vizioni më të qartë mbi ngjarjen, personazhet, kontributet dhe rolin e firmëtarëve të saj në historinë e Shqipërisë. Mjafton këto detaje për të kuptuar boshllëkun e madh në sistemin e kujtesës kolektive dhe në formimin tonë qytetar e historik.

Ky takim kishte nevojë jetike të shoqërohej me rishkrim të historisë, me reflektim kombëtar dhe me kalim nga historia mbi bazë ideologjike, tek historia unike dhe profesionale e shtetit. Përvojat e tranzicionit treguan se me gjithë vullnetin e mirë, shteti e shoqëria nuk ishin tërësisht të përgatitur sa duhet. Sfidat u lexuan në ndikimet afatshkurtra ndaj edhe rezultatet janë shumë më të ndryshme nga nevojat. Nëse modeli totalitar i partisë-shtet ishte përgjegjës për deformimet historike mbi emrat, ngjarjet dhe kriteret e vlerësimit, në tranzicionin drejt demokracisë funksionale, elitat e reja politike dhe aktorët e rinj politikë vijuan të krijojnë sisteme paralele vlerësimi, në varësi nga interesat elektorale apo prioritetet politike afatshkurtra. Nevoja për reflektim dhe ecje përpara mbeti peng i kalkulimeve politike të sotme mbi të kaluarën.

Sjellja ndaj Pavarësisë dhe sistemit të meritave historike mbetën disproporcionale jo vetëm në Shqipëri, por edhe në hapësirën shqiptare në rajon. Rendja pas emrave të krahinës apo lidhjeve familjare si dhe kufizimi i memories në vetëm 3-5 emra nga shumëfish emra prej atyre që hodhën themelet e shtetit u gjet si zgjidhje afatshkurtër, u promovua dhe

u imponua si sistem i ri vlerësimi. Figurat e Kosovës në ngjarjet e Pavarësisë dhe jetësimin të shtetit vijojnë të mos jenë aq të njohura në Shqipëri dhe anasjelltas, edhe për figurat dhe publikun në Prishtinë dhe në Shkup. 100-vjetori ishte rasti i parë kur më shumë se një shtet shqiptar u përfshi në festime, të cilat edhe në këtë rast, ishin më të prirura drejt efektit elektoral dhe imazhit publik sesa ndaj ndonjë planveprimi ndërshtetëror për trajtim të integruar dhe të gjithëpranuar të ngjarjeve dhe personazheve.

Si përfundim, duhet pranuar rreth 3 dekada pas ndryshimit të sistemit politik, tregimi mbi Pavarësinë ende nuk është i plotë. Ai vuan nga subjektivizmi, rastësitë, personalizimi, formalizmi dhe show politik. Në kontrast me pritshmëritë e larta publike sjellja shtetërore dominohet nga agjendat politike dhe se etërit themelues nuk janë pranuar siç duhet me të gjithë domethënien që mbart ky emërtim. Nisma serioze shkencore në qarqet akademike dhe debati publik midis profesionistëve të fushës përbën një shtysë e ndihmë që pas 100 vitesh shteti e shoqëria të ketë një këndvështrim tjetër më solid, më profesional dhe më horizontal në dosjen e Pavarësisë dhe vitet e shtetformimit, në mënyrë që brezat e ardhshëm të përfitojnë tregimin e plotë për Pavarësinë, ngjarjet, emrat dhe të pathënat e plota të tyre.

S u m m a r y

THE (IN) COMPLETE ACCOUNT OF INDEPENDENCE:

THE REWRITING OF HISTORY AND THE STATE'S ATTITUDE AFTER 1990S

More than a century from the declaration of independence the Albanian state and society have not yet concluded the process of appraising their founding fathers. During the communist period these historical figures were judged primarily on ideological grounds or on the political attitude they and their families held during the monarchy years and WWII. A large part was denigrated, overlooked or even erased from the country's public memory in compliance with the political guidelines of the time. The establishment of the pluralist system marked a new encounter of the state and society with the

signers of the Declaration of Independence, their contribution, biography, life and professional activity.

This paper deals with the process of reassessing some of the main historical figures of Independence, the features of the political developments and the institutions' attitude towards this process, the negative influence caused by political interests and the lack of commonly accepted criteria of reassessment. The tendency to establish links with the independence's personalities, their later political views and the present political attitudes, not only delayed the process but also crippled the collective public and state memory. In this paper we will argue that the attitude towards Independence and the system of historical values are disproportional, subjective and politically motivated, and as a result almost three decades after the change in the political system, the account of Independence remains incomplete. The closure of this process through a social reflection and a professional and academic approach would have a positive influence on the national memory and the state and civil culture in general.